



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 95/6 prot.

Tiranë, më 28.2.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 13.2.2023, është njoftuar vendimi nr. 606, datë 21.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.2.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 16.2.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mariola Mërtiri*”,² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. 11822 prot., datë 31.10.2017, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariola *** Mërtiri*”, raport i deklasifikuar plotësisht, pas kërkesës së Komisionit për përditësim dhe deklasifikim informacioni.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, znj. Mariola Mërtiri.

2.4 **Gjetjet e ONM-së.** Gjatë hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli (pasurinë, figura dhe aftësitë profesionale), Komisioni ka administruar tre (3) *gjetje*, të paraqitura nga vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b”⁴, të aneksit të Kushtetutës dhe

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***prot., datë **.10.2018.

³ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **.5.2022.

⁴ [...] 3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi

nga neni 49, pika 10⁵, e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht, (i) *gjetja* me nr. *** prot., e datës **.7.2022; (ii) *gjetja* nr. *** prot., e datës **.10.2022; dhe (iii) *gjetja* nr. *** prot., e datës **.10.2022.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur⁶, ka vlerësuar si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurorë krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet, pagimin e detyrimeve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të dalë nga hetimi administrativ lidhur me këtë kriter, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, në përfundim të vlerësimit tërësor të çështjes, ka vlerësuar se: [...] *subjekti ka bërë deklaram të saktë të pasurive të saj dhe personave të lidhur dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive të saj. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit Dh të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, duke u gjendur në kushtet me përcaktuara nga germa “b” e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, denoncimet e publikut dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se: [...] *për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me denoncimet, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me kriterin*

ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit [...].

⁵ [...] Gjetja, e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit [...].

⁶ Për më tepër referohuni në f. 69, të vendimit.

e vlerësimit profesional, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e përcaktuara nga germa “c” e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash⁷, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁸, e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁹, e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 16.2.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. 95/3 prot., aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Objekti i këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ për të tria kriteret e kontrollit, e për këtë arsye, si konkluzion, ONM, pasi vlerëson se arsyetimi i Komisionit nuk është i plotë dhe bindës në evidentimin dhe trajtimin e mangësive të konstatuara, rekomandon që procesi i rivlerësimit për znj. Mërtiri të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Sipas vlerësimit të ONM-së, ankimi i këtij vendimi do të mundësojë që Kolegji: (i) Të kryejë një analizë të saktë financiare, ku të gjitha çështjet në fjalë të vlerësohen qartë dhe siç duhet; (ii) Të rishikojë dhe vlerësojë të gjitha çështjet e ngritura lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, duke marrë në konsideratë të gjitha faktet që mund të ndikojnë në një vlerësim tërësor të çështjes për subjektin e rivlerësimit.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

⁷ Kryesuesja e trupës, znj. E. Çiftja, ka dalë me mendim në pakicë.

⁸ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁹ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

8. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, të figurës, vlerësimin e aftësive profesionale, duke bërë kështu pjesë të shkaqeve të këtij ankimi, për sa parashtrohet edhe në aktin Rekomandim, si dhe (3) gjetjet e paraqitura nga ONM-ja.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 606, datë 21.12.2022, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A Kontrolli i pasurisë

12. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

13. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariola Mërtiri, është bërë subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2008, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve

publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave privatë periodikë për vitet 2008 - 2016 (në vijim DV -20--), dhe në datën **.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, janë:

15. Pasuri nr. 1, Apartament me sip. 83,88 m², në lagjen “**”, Fier**

15.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe ndërtimore 83,88 m², i ndodhur në lagjen “****”, Fier, i përfutuar sipas kontratës noteriale me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë **.6.2011, në vlerën 4.500.000 lekë. Në bashkëpronësi. *Kësti i parë* për blerjen e këtij apartamenti në vlerën e 2.260.000 lekë është likuiduar në datën **.6.2011, nga të cilat 1.000.000 lekë i janë dhuruar bashkëshortit tim nga vëllai, ***,***, dhe shuma tjetër prej 1.260.000 lekë, na është dhuruar nga vjehri im nga kursimet e tij nga puna dhe emigracioni. *Kësti i dytë*, prej 2.240.000 lekë, është likuiduar nga ne më datë **.8.2011, në momentin që është mundësuar kredia nga Banka *** ***, Dega Fier. Në lidhje me dhurimin e lekëve që janë bërë nga vjehri dhe kunati im (përkatësisht *** dhe ***,***), fakti konfirmohet prej tyre në deklaratat noteriale të lëshuara prej tyre.

15.1.1 Në faqen nr. ** të kësaj deklarate, subjekti ka detajuar më tej se: *“Si burim krijimi të të ardhurave nga vjehri janë të ardhura të tij si kursime familjare dhe nga emigracioni nga viti 1992-1998 në shtetin grek. Po ashtu të ardhura dhe nga punësimi në blegtori në rrethin e Gjirokastrës e në transportin e udhëtarëve. Periudhë punësimi informale... Si burim krijimi i shumës 1.000.000 lekë që bashkëshortit tim ***,*** i është dhuruar nga i vëllai ***,***, janë të ardhura që rrjedhin nga paga e biznesi i tij. Në lidhje me këtë po ju paraqesim një kontratë shitje të kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k.”.*

15.1.2 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: *“Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Kredi te ***, në shumën 2.240.000 lekë. Norma e interesit 3%. Afati i shlyerjes 20 vjet, kësti 12.500 lekë, i pandryshueshëm. Bashkëlidhur kontrata e kredisë, hipotekimit, certifikata e pronësisë, kontrata për blerjen e sendit në të ardhmen dhe dokumentet e pronësisë të investitorit dhe pronarit të truallit. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer është 1.759.871,75 lekë.

15.2 Në *DV-2011*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjta të dhëna sikurse në D. -Vett., ndërkohë që në rubrikën: *“Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”*, kredinë bankare pranë ***, ka deklaruar detyrim të mbetur në shumën 2.190.148 lekë.

15.3 Komisioni, ndër të tjera, ka administruar aktet noteriale të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me titullin e origjinës së pronësisë së apartamentit, kontratën e shitjes së sendit në të ardhmen me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2011¹⁰, si dhe kontratën e

¹⁰ Kjo kontratë është nënshkruar midis palës shitëse ***,*** dhe palës blerëse ***,***, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me objekt: *“shitjen në të ardhmen e një apartament banimi me sipërfaqe 95 m², për çmimin total 4.500.000 lekë, kësti i parë prej 2.260.000 lekë është likuiduar i plotë sot më datë **.6.2011. Kësti i dytë dhe i fundit prej 2.240.000 lekë do të likuidohet kur të mundësohet kredia bankare në emër të z. ***,***, pranë Bankës ***,*** filiali Fier.*

shitblerjes me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë **.4.2012, me palë shitëse *** dhe ***.***, të përfaqësuar me prokurë noteriale të datës **.4.2012, nga shtetasi z. ***.***, dhe palë blerëse ***.***, bashkëshorti i subjektit, ku përcaktohet se vlera është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale, nëpërmjet bankës.

15.4 Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të hetimit administrativ¹¹, *** konfirmon se *** dhe ***.*** (bashkëkredimarrës), rezultojnë të jenë klientë kredimarrës të bankës për kredinë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.8.2011, në shumën 2.240.000 lekë, kredi e disbursuar në llogarinë e ***.***, në datë **.8.2011. Rezulton se në datën **.8.2011, nga kjo llogari, shuma prej 2.207.800 lekë, është transferuar në favor të z. ***.***, me përshkrimin: “*Likuidim Blerje Apartamenti*”.

15.5 Për sa i përket burimit të kështit të parë, në vlerën 2.260.000 lekë, nga hetimit administrativ, ka rezultuar se në dokumentacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI-së, gjenden aktet:

- (i) Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2012, të deklaruesit z. ***.***, në të cilën deklarohet se i ka dhuruar vëllait, z. ***.***, shumën 1.000.000 lekë, pa kundërshpërblim për blerjen e një apartamenti ndodhur në qytetin e Fierit. Shuma e dhuruar është dhënë jashtë zyrës noteriale në prill të vitit 2011. Këto janë të ardhura që vijnë nga biznesi i tij. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës edhe kontratën me nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.9.2007, për shitje kuotash të shoqërisë “****” sh.p.k., ndërmjet palës shitëse, znj. ***.*** (bashkëjetuesja e kumatit, ***.***), dhe palës blerëse, z. ***.***, për shumën 13.393.118 lekë;
- (ii) Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2012, të shtetasve z. *** dhe ***.*** (vjehtëri dhe bashkëshorti i subjektit), të cilët deklarojnë se, në muajin prill 2011, z. ***.***, i ka dhuruar vlerën prej 1.260.0000 lekë ***.***, me qëllim plotësimin e vlerës që i nevojitej për blerjen e një apartamenti banimi të ndodhur në Fier. Burimi i kësaj shume deklarohet “*kursime familjare*”. Subjekti i rivlerësimi ka bashkëlidhur edhe aktet: (a) kontratë huaje të datës **.11.1994, me palë huadhënës (vjehtëri i saj) ***.***, dhe palë huamarrës ***.***, për shumën 960.000 lekë, me afat kthimi **.11.1995; (b) kontratë shitblerje mjete nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.11.1999, me të cilën z. ***.*** ka blerë një automjet (autobus), në vlerën 2.000.000 lekë.

15.6 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka rideklaruar se bashkëshorti i saj, ***.***, në prill të vitit 2011, ka përfituar dy dhurime nga babai dhe vëllai i tij, duke specifikuar më tej se:

- (i) Për burimin e krijimit të dhurimit nga (vjehtëri), z. ***.***, kanë shërbyer kursimet familjare, krijuara nga: (1) Të ardhura nga emigracioni (vitet 1992-1998); (2) Kthimi i vlerës së huas nga shtetasi ***.***, sipas kontratës së huas; (3) Të ardhura nga dhënia me qira e mjeteve “autobus” shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 2002-2007; (4) Të ardhura nga punësimi i z. ***.***, pranë shoqërisë “****” sh.a., shoqërisë “**** sh.p.k., shoqërisë ***; (5) Të ardhura nga punësimi i vjehtërit (mësuese në rrethin e Fierit); dhe (6) Të ardhura të realizuara nga blegtoia (prej vitit 2008).

¹¹ Shkresa e ***-së me nr. *** prot., datë **.7.2020.

(ii) Si burim krijimi për dhurimin nga z. ***.**, ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga puna dhe biznesi, specifikisht: (1) Punësimi pranë shoqërisë “****” sh.a., viti 2004; (2) Punësimi pranë shoqërisë “****”, prej vitit 2005 deri në dhjetor 2010; (3) Të ardhura të realizuara nga shitja e kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k., nga bashkëshortja/bashkëjetuesja e tij, znj. ***.**, (4) Të ardhura të realizuara nga punësimi i bashkëshortes/bashkëjetuese, znj. ***.**. Të njëjtat burime për personat e tjerë të lidhur, subjekti ka deklaruar dhe në përgjigje të Pyetësorit nr. 2¹².

15.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi ka konstatuar se: (i) Bazuar në analizën financiare dhe në të ardhurat e deklaruara nga subjekti, duket se personi tjetër i lidhur, ***.**, nuk ka pasur mundësi financiare për dhurimin e shumës prej 1.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe investimeve në kapitalin e shoqërive “****” sh.a. dhe “****.” sh.p.k; (ii) Duket se personi tjetër i lidhur, ***.**, nuk ka pasur mundësi financiare për dhurimin e shumës prej 1.260.0000 lekë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe mundësimin e investimit të bashkëshortit të subjektit ***.**, në kapitalin e “****.” sh.p.k. (sikundër do të trajtohet në mënyrë të detajuar në vijim); (iii) Shpjegime lidhur me përfitimin e kredisë së butë dhe shitjen më pas të apartamentit të përfituar nga kjo kredi.

15.8 Në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se:

(i) Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, *“Konstatoj se, ndonëse shuma 1.000.000 lekë dhuruar bashkëshortit tim i përket viti 2011, në analizën e personit tjetër të lidhur është përlllogaritur investimi i kryer prej tij në dy shoqëri tregtare, përkatësisht në vitin 2002 dhe 2004. Analiza ekonomike e hartuar në të tillë mënyrë nuk ka logjikë financiare, pasi një investim i kryer në vitin 2002 apo 2004 nuk mund të llogaritet si shpenzim në vitin 2011. ... Analiza financiare e kryer është shtrirë në të gjitha pasuritë e tjera të personit tjetër të lidhur, tej parashikimit ligjor dhe qëndrimit të KPA-së, duke përfshirë si shpenzim investimin e kryer nga ***. (kunati im) në shoqërinë *** sh.a... Kjo analizë financiare nuk ka marrë në konsideratë që investimi i kryer në këto dy shoqëri është rimarrë...¹³”*

(ii) Lidhur me të ardhurat e vjehrrit: *“... konstatoj se nuk janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga kthimi i huas në vitin 2009, që rrjedhin nga një kontratë huaje e lidhur rregullisht përpara autoritetit në datën **.11.1994 dhe që është kthyer në titull ekzekutiv me vendim gjyqate... Po ashtu në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti blegtoral, pasi nuk provohet vlera e tyre e fituar ndër vite nga vjehrrri i subjektit... në përlllogaritjet e kryera duhet të ishte konsideruar fakti se familjet bujqësore shpenzimet e jetesës i kanë më të vogla se familjet e tjera që llogariten nga INSTAT, pasi koston e ushqimit*

¹² Bashkëlidhur pyetësorëve, subjekti ka vënë në dispozicion: (i) Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, viti 2004, shoqëria “****” sh. a.; (ii) Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 2005-2010, të shoqërisë “****”; (iii) Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 2006-2012, të shtetases ***.**, te shoqëria “****” sh.p.k.; (iv) Të ardhura të realizuara nga shitja e kuotave të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “****” sh.p.k., nga bashkëshortja/bashkëjetuese, e tij znj. ***.**, në vlerën e 4.910.810 lekë, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., *** kol., datë **.9.2008; (v) Të ardhura të realizuara nga shitja e kuotave të shoqërisë “****” sh.p.k., nga bashkëshortja/bashkëjetuese, sipas kontratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2007. Në cilësinë e palës shitëse, ***.**, e cila zotëron 70% të aksioneve, duke përfituar nga shitja, vlerën e 13.393.118 lekë.

¹³ Referohuni shpjegimeve të subjektit në f. 2, e në vijim, ndaj rezultateve të hetimit administrativ.

*e prodhojnë vetë... Në analizën financiare të personit tjetër të lidhur... Njësia Ekonomike/Ligjore, ka përlllogaritur një investim të kryer në vitin 2004 në shoqërinë ***, duke e kryer analizën njësoj si për subjektin e lidhur. Mendoj se, kjo përlllogaritje përveçse nuk ka logjikë financiare, nuk është bërë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore”¹⁴.*

15.9 Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, ka rishikuar analizën financiare të personave të tjerë të lidhur, shtetasve ***, dhe ***, duke konkluduar, ndër të tjera, se¹⁵: [...] (i) *Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, ***, për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë në vitin 2011, nga analiza financiare duket se dhuruesi dhe bashkëjetuesja e tij kishin mundësi financiare të mjaftueshme ..., si dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës nga viti 2005 deri në mars të vitit 2011... Në këtë analizë u përfshinë vetëm të ardhurat nga paga të dhuruesit dhe bashkëjetueses së tij për periudhën 2005 – mars 2011. Investimet e kryera nga dhuruesi në vitet 2002 dhe 2004 nuk janë përfshirë në këtë analizë financiare...*

(ii) *Lidhur me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, ***, për dhurimin e shumës 1.260.000 lekë në vitin 2011. Nga analiza financiare duket se dhuruesi dhe bashkëshortja e tij kishin mundësi financiare të mjaftueshme për dhurimin e vlerës ..., si dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës nga viti 2005 deri në mars të vitit 2011. Në analizën financiare, trupi gjykues përfshiu vetëm ato të ardhura të deklaruara për dhuruesin, për të cilat u provua burimi i ligjshëm i krijimit... [...].*

(iii) *Lidhur me kredinë e butë, trupi gjykues konstatoi se ajo është përfituar nga subjekti bazuar në ligjin nr. 9232 të vitit 2004. Subjekti ka përfituar kredi të butë për mbulimin e një pjesë të pasurisë apartament, të blerë prej saj në tregun e lirë. Kreditë me kushte lehtësuese përfshihen në programin e banesave me kosto të ulët, si një nga programet sociale të strehimit, të parashikuara në këtë ligj. Në nenin 4, të ligjit të sipërpërmendur, janë përcaktuar kushtet e përfitimit nga programet sociale. Procedura për përzgjedhjen e familjeve përfituese ndiqet nga bashkia dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak përkatës. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit. Trupi gjykues konstatoi se kjo procedurë përzgjedhëse e subjektit për përfitimin e kredisë ka kaluar të gjitha fazat dhe është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Fier. Deri më sot nuk ka rezultuar ndonjë revokim i miratimit të kredisë së butë për subjektin e rivlerësimit nga organet kompetente miratuese dhe kontrolluese apo dhe nga gjykata. Trupi gjykues nuk konstatoi as problematikë lidhur me shitjen më pas të apartamentit në qytetin e Fierit, pasi subjekti nuk ndodhej në kushtet kufizuese të parashikuara nga neni 20 i ligjit nr. 9232/2004, i ndryshuar. Për këtë pasuri apartament nuk është vendosur ndonjë kufizim në kartelën përkatëse të pasurisë të lëshuar nga ASHK-ja. Trupi gjykues nuk konstatoi konflikt interesi me palën shitëse të pasurisë apartament në qytetin e Fierit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë **.10.2011,*

¹⁴ Referohuni shpjegimeve të subjektit në f. 5, e në vijim, ndaj rezultateve të hetimit administrativ.

¹⁵ Referohuni f. 16, e në vijim të vendimit të Komisionit.

konfirmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime që kanë lidhje me palën shitëse të pasurisë apartament banimi në qytetin e Fierit [...].

16. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së të datës 16.2.2023, për vlerësimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament me sip. 83,88 m², ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, lidhur me analizën financiare të kryer mbi burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur, dhuruesve ***.*** dhe ***.***, si dhe përfundimit të arritur lidhur me përfitimin e kredisë së butë nga ana e familjes së subjektit të rivlerësimit dhe shitjes së kësaj pasurie më pas, duke analizuar si më poshtë:

16.1 *Për sa i përket ligjshmërisë së burimit të shumës së dhuruar nga shtetasi ***.***, subjektit të rivlerësimit në prill të vitit 2011*, Komisioneri Publik vlerëson se analiza e kryer nga Komisioni, mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk përputhet me aktet në dosje dhe atë çfarë ka rezultuar nga hetimi administrativ. Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, si një nga burimet e të ardhurave të dhuruesit ***.***, ka deklaruar edhe punësimin e tij pranë shoqërisë “****” sh.a., që nga vitin 2004, fakt për të cilin ka paraqitur pranë Komisionit edhe vërtetimin nr. *** prot., datë **.1.2020, mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për të ardhurat e dhuruesit për periudhën prill – gusht 2004.

16.1.1 Nga aktet e administruara, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. *** regj., datë **.10.2002, me aksionerë z. ***.*** (i cili për nga të dhënat rezulton i njëjtë me z. ***.***), dhe shtetasin e huaj ***, me një kapital themeltar të shoqërisë prej 10.000.000 lekë, nga të cilat 60% të aksioneve të kapitalit, ose 6.000.000 lekë, i përkasin shtetasit ***.*** Me vendim gjykate nr. ***, datë **.3.2003, z. ***.*** është emëruar drejtor i shoqërisë “****” sh.a.¹⁶.

16.1.2 Bazuar në sa më sipër, Komisioneri Publik e gjen jo bindës arsyetimin e Komisionit (në pikën 1. 45 të vendimit), se subjekti i rivlerësimit duhet të justifikojë burimin e ligjshëm brenda kufijve të kësaj shume objekt dhurimi. Ky vlerësim i Komisionit nuk duket shterues, pasi nga aktet e administruara dhe në një vlerësim tërësor të çështjes, rezultojnë fakte se personi tjetër i lidhur ka investuar në aktivitet privat shuma të konsiderueshme, aktivitet nga i cili janë gjeneruar pikërisht të ardhurat e deklaruara si një nga burimet e krijimit të dhurimit. Nisur nga ky rast specifik, vlerësojmë se nuk do të ishte një analizë objektive dhe tërësore nëse ky fakt do të përjashtohej *a priori*, bazuar në një interpretim formal dhe të ngushtë të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016. Më së paku, në analizë duhen përfshirë edhe shpenzimet, të cilat kanë shërbyer për krijimin e biznesit nga i cili janë përfituar të ardhurat për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë, pasi këto shpenzime paraqesin lidhje organike dhe logjike, të cilat nuk mund të

¹⁶ Me vendimin nr. **, të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë “****” sh.a., datë **.6.2003, për paaftësi në kryerjen e detyrës është shkarkuar z. ***.*** dhe është emëruar z. ***.*** (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në detyrën e drejtorit të shoqërisë. Ky vendim është pasuar me vendimin e gjykatës nr. ***, dt.**.6.2003, për shkarkimin nga detyra të z. ***.*** dhe emërimin e z. ***.***.

mëvetësohen/parcelizohen për efekt të procesit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë në këtë mënyrë, si të ardhurat e krijuara/përfituara nga kjo shoqëri, ashtu dhe investimi për të.

16.1.3 Në të njëjtën logjikë si më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në analizën financiare të personit tjetër të lidhur/dhuresit, duhet të përfshihet edhe investimi i tij në shoqërinë “***” sh.p.k., pasi nga aktet në dosje rezulton se kjo shoqëri është themeluar në datë **5.2004, dhe shtetasi ***.***, zotëron 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë (10.000.000 lekë), duke investuar në të vlerën prej 4.000.000 lekë. Në këto kushte, referuar faktit se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit dhe të ardhurat nga punësimi i dhuresit pranë shoqërisë “***” sh.p.k., si një nga burimet e krijimit të shumës së deklaruar të dhuruar, vlerësojmë se në analizën financiare do të duhej të përfshihej dhe investimi i dhuresit në këtë kompani. Për rrjedhojë, nga analiza e kryer për personin tjetër të lidhur, z. ***.***, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhuruar prej 1.000.000 lekë në prill 2011, do të rezultonte me pamjaftueshmëri financiare të këtij të fundit në masën prej rreth - 7.3 milionë lekë, duke përfshirë në analizë vetëm shpenzime jetese sipas përbërjes familjare të dhuresve dhe investimet e kryera minimalisht në dy shoqëritë e mësipërme.

16.1.4 Nga ana tjetër, edhe në vlerësim të pretendimeve të subjektit, se nuk është trajtuar në analizën e kryer nga Komisioni fakti që për dy shoqëritë më sipër janë shitur kuotat dhe janë përfituar të ardhura nga shtetasi z. ***.***, nga aktet në dosje, rezulton se kuotat e shoqërisë “***” sh.p.k., janë shitur në datën **9.2004, në vlerën prej 400.000 lekë, ndërsa të ardhurat e përfituara nga ***.***, nga likuidimi i shoqërisë “***” sh.a., bazuar në raportin e likuidatorit të shoqërisë, janë në shumën rreth 2.6 milionë lekë. Për sa më sipër, megjithëse subjekti nuk provoi transaksionin monetar, edhe nëse merren në konsideratë këto të ardhura, të përfituara nga shitja dhe likuidimi në vlerën totale rreth 3 milionë lekë në harkun kohor 2004-2006, përsëri do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare e burimeve të ligjshme të dhuresit për të mbuluar shumën prej 1.000.000 lekë, dhuruar subjektit dhe bashkëshortit të saj.

16.2 Komisioneri Publik, edhe për sa i përket mundësisë financiare dhe ligjshmërisë së burimit të shumës së dhuruar prej 1.260.000 lekë nga z. ***.***, në prill të vitit 2011, vlerëson se analiza e kryer nga Komisioni, nuk përputhet me aktet në dosje. Në vlerësim të kësaj analize, në raport me aktet e administruara, vërehet se në mesin e të ardhurave të dhuresit ***.***, Komisioni ka përfshirë të ardhurat nga qiraja e një mjeti autobusi për periudhën 2005 - tetor 2007, si dhe shitjen e tij në vitin 2007. Ndërkohë, rezulton se si burim krijimi për këtë pasuri, janë deklaruar të ardhurat nga punësimi informal në emigracion, i shtetasit ***.***, të ardhura të cilat Komisioni, referuar vendimit të arsyetuar, nuk i ka përfshirë në analizë financiare të dhuresit, pasi nuk provohet burimi i ligjshëm i tyre.

16.2.1 Në kuadër të vlerësimit të të ardhurave të mjaftueshme dhe të ligjshme të dhuresit ***.***, rezulton se nga aktet e administruara, të ardhurat e dhuresit kanë shërbyer edhe për investimin në një shumë prej 4.000.000 lekë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në kapitalin e shoqërisë “***” sh.p.k. Gjatë hetimit është administruar, ndër të tjera, deklarata noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë **2.2016, e dhuresit, shtetasit ***.***, depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së. Në këtë akt-noterial deklarohet se: “... një pjesë të të ardhurave, sikundër cituar në deklaratë me burim emigracioni nga vitet 1992-1998, dhe nga punësimi informal transport udhëtarësh, ia ka dhënë djalit ***.***, për çeljen e aktivitetit

të tij tregtar me shoqërinë “***” sh.p.k., në formën e investimit fillestar”. Për më tepër, rezulton se subjekti vetë ka kërkuar përfshirjen në analizën financiare të dhuruesit, të gjitha të ardhurave e tij që nga viti 1990, përfshirë dhe të ardhurat e siguruara nga ky i fundit nga punësimi pranë shoqërisë “***” sh.a., ndërkohë, nga ana tjetër, subjekti kërkon përjashtimin nga analiza financiare të investimit të shumës 4.000.000 lekë, dhënë bashkëshortit të saj.

16.2.2 Bazuar në arsyetimin si më sipër, për personin tjetër të lidhur, ***.**, Komisioneri Publik, vlerëson se në të njëjtën logjikë, në analizën financiare të personit tjetër të lidhur, ***.**, në zërin shpenzime duhet përfshirë dhe investimi prej 4.000.000 lekë, deklaruar dhënë bashkëshortit të subjektit në vitin 2004, si dhe nuk duhej të ishin përfshirë të ardhurat e siguruara nga qiraja dhe shitja e mjetit “autobus”. Për sa më sipër konstatuar, nga analiza e burimeve të ligjshme financiare të personit tjetër të lidhur, do të rezultonte pamjaftueshmëri prej rreth – 3 milionë lekë, për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shumat e dhuruara bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në vitet 2004 dhe 2011.

16.3 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë dhe justifikojë bindshëm burimet e ligjshme të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, kunatit, z. ***.**, dhe vjehrrit, z. ***.**, për shumën e deklaruar të dhuruar prej 2.260.000 lekë, që ka shërbyer për pagesën e këstit të parë të pasurisë “apartament banimi”, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga neni 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016.

16.4 Mbi ligjshmërinë e përfitimit të kredisë së butë nga ana e subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit me sip. 95 m² në Fier, shitja e këtij apartamenti dhe çmimi në dukje preferencial.

16.5 Ky shkak ankimi megjithëse gjen trajtim në kontrollin e kriterit të pasurisë, vlerësohet i ndërlidhur edhe me etikën/integritetin e magjistratit, duke përbërë bazë edhe për një vlerësim tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

16.6 Nga aktet e administruara, ka rezultuar se gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Fier, me vendimin nr. **, në datë **.7.2010, të Këshillit Bashkiak Fier, subjekti i rivlerësimit ka përfituar duke u përfshirë në listën e familjeve të pastreha, kredi lehtësuese për blerjen e banesave me kosto të ulët.

16.7 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar praktikën përkatëse nga Bashkia Fier, si dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar lidhur me këtë çështje, duke i kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me plotësimin e kriterëve ligjore për përfitimin e kredisë, çmimit në dukje preferencial për blerjen e apartamentit, si dhe ligjshmërinë e shitjes së tij¹⁷. Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] *Procedura për përzgjedhjen e familjeve përfituese ndiqet nga Bashkia dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak përkatës. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësisia e vetëqeverisjes vendore... Trupi gjykyes nuk konstatoi as problematikë lidhur me shitjen më pas të apartamentit... nuk konstatoi konflikt interesi me palën shitëse të pasurisë [...]*.¹⁸

¹⁷ Për më tepër referohuni shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të Pyetësorit nr. 4, të Komisionit, si dhe përgjigjeve ndaj rezultateve të hetimit.

¹⁸ Për më tepër referohuni në pikën 1.55, f. 18-19, të vendimit të Komisionit.

16.8 **Komisioneri Publik**, mbështetur në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së dhe përmbajtjes së *gjetjeve* të vëzhguesit ndërkombëtar, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Komisioneri Publik vëren se sipas legjislacionit që rregullon rastet e përfitimit të kredive të lehtësuara, neni 4 i ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, përfitojnë strehim: (i) individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe (ii) familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet: a) nuk kanë në pronësi një banesë; b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi; c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore. Sipas, pikës 2, të këtij neni, përfshihen në njërin nga shkronjat “a”, “b” dhe “c”, si më sipër, vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme. Ndërsa referuar kreut V, të këtij ligji “Banesat me kosto të ulët”, kategorizimi i familjeve, të pastreha, që përfitojnë banesa me kosto të ulët janë: a) familjet që në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së qeverisjes vendore nuk kanë në pronësi një banesë; b) familjet, që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit; c) familjet, që kanë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në nenin 19¹⁹ të këtij ligji.

16.8.1 Nisur nga sa më sipër, në raport me aktet e administruara, rezultojnë se në pikat si më sipër, përfshihen vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme dhe brenda kriterëve të përcaktuara nga ligji. Duke vlerësuar rastin në raport me kushtet financiare faktike të subjektit të rivlerësimit në momentin e aplikimit, rezultojnë se kjo normativë ligjore, nuk plotësohet nga ana e subjektit, pasi të ardhurat familjare të tij kanë qenë të larta. Në këtë konstatim, mbajmë në konsideratë gjithashtu, faktet si më poshtë:

(i) Subjekti i rivlerësimit nuk provoi nivelin e të ardhurave maksimale, të llogaritura dhe aprovuara nga Ministria që mbulonte fushën e strehimit në momentin e aplikimit të saj. Konstatohet se të ardhurat e familjes së subjektit të rivlerësimit, referuar praktikës së aprovimit të kredisë lehtësuese të vitit 2011 (afërsisht 170.000 – 190.000 lekë/muaj), rezultojnë më të larta se baza mbi të cilat ka vendosur Këshilli Bashkiak për raste të ngjashme (150.000 lekë). Referuar këtyre të dhënave për qëllimin e aplikimit, të ardhurat familjare për frymë të subjektit, rezultojnë më lartë në krahasim me përfituesit e tjerë.

(ii) Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe provojë, nëse organet shtetërore miratuese të kredisë së butë (Bashkia Fier), ishin në dijeni të vlerës së aksioneve të bashkëshortit të subjektit në shoqërinë “***” sh.p.k. Nga të dhënat e shoqërisë “***”, rezultojnë se kapitali themeltar i kësaj shoqërie prej 4.000.000 lekë, u rrit më tej në vitin 2004, edhe me shumën 3.000.000 lekë. Nga aktet e administruara, nuk provohet me ndonjë akt, zvogëlimi apo humbja e kapitalit themeltar, apo i aksioneve të personit të lidhur, bashkëshortit, në këtë

¹⁹ [2]. Kur banesa me kosto të ulët sigurohet përmes blerjes nga tregu, nëpërmjet një kredie hipotekore nga bankat e nivelit të dytë, me interesa të lehtësuara nga shteti, niveli maksimal i të ardhurave llogaritet nga Ministria që mbulon fushën e strehimit, bazuar në vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg për çdo qytet, normat e strehimit, kushtet e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë dhe treguesin e aftësisë paguese jo më shumë se 30 për qind [...].

shoqëri, në kohën e aplikimit për kredi të butë. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë pretendimet e saj mbi humbjet nga ky investim.

(iii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me përgjegjësinë e Bashkisë Fier për ruajtjen e praktikës përkatëse të kredisë së butë, përfshirë këtu aplikimin e saj, mbetën deklarative dhe nuk shpjegojnë arsyet e mosdeklarimit të aplikimit në vitin 2010, para Komisionit, sikurse nuk dha shpjegime përse këto akte nuk mund të gjendeshin.

(iv) Për sa më sipër, ligji nr. 9232/2004, specifikisht kapitulli V i tij, qartësisht, përcakton kriteret që duhen plotësuar për banesat me kosto të ulët, përfshirë këtu edhe neni 19/2, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë banesë të përfituar nga programet sociale, megjithëse vijon të paguajë kredinë e butë²⁰, veprim juridik ky, i cili duket se bie ndesh me nenin 20/1²¹, të ligjit “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar.

16.8.2 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë përfitues jashtë kriterëve ligjore të kredisë lehtësuese me statusin e familjes së pastrehë në qytetin e Fierit, në të njëjtën kohë që ushtronte detyrën e prokurorit në këtë qytet. Duket se ky përfitim është rrjedhojë e funksionit që ushtronte subjekti i rivlerësimit, duke rënë ndesh kështu me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale. Kjo situatë e konstatuar, së bashku me çmimin në dukje preferencial si dhe shitjen e këtij aseti në kundërshtim me përcaktimet ligjore, parë në raport dhe me procedimet penale që subjekti i rivlerësimit ka ndjekur pas vitit 2011 ndaj Bashkisë Fier (trajtuar më gjerësisht në kriterin e aftësive profesionale), në një vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, çon drejt aplikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji, duke konkluduar, se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

17. Mosdeklarimi i aksioneve të bashkëshortit në masën 40% në shoqërinë “**” sh.p.k.**

17.1 Në *D.-Vett.*, subjekti rivlerësimit nuk rezultoi të ketë deklaruar posedimin në masën 40% të kuotave të bashkëshortit të saj në shoqërinë “****” sh.p.k.

17.2 Në *DV-2008*, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, z. ***.***, ka deklaruar: Zotëroj 40% të aksioneve të shoqërisë “****” sh.p.k., e regjistruar me vendimin nr. ***, datë **.5.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. *Vlera*: 4.000.000 lekë. *Burimi i krijimit*: të ardhura familjare të prindërve. Kjo shoqëri nuk kryen aktivitete që prej muajit maj 2007, dhe të ardhurat e saj janë 0 lekë. Zotërimin e 40% të aksioneve në këtë shoqëri, bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar dhe në *DV-2009*, në deklaratën e plotësuar nga ai përpara fillimit të detyrës në funksionin e Drejtorit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Fier.

17.3 Komisioni, për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi ka konstatuar se: “... pavarësisht statusit pasiv të kësaj

²⁰ Për më tepër referohuni në *DV-2017*, në të cilën subjekti deklaroi shlyerjen e kredisë në shumën 143,730.60 lekë dhe ka për të shlyer shumën 1,670,487.22 lekë.

²¹ [...] “Kufizimet” 1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t’i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë të një person tjetër, apo ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë [...].

shoqërie, krijimit të aksioneve para martese nga bashkëshorti i subjektit apo para fillimit të detyrës si magjistrate, si dhe mospërfitimit të të ardhurave nga kjo shoqëri, subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur detyrimin për deklarimin në Deklaratën “Vetting” të kuotës prej 40%, të aksioneve në shoqërinë “***” sh.p.k.”. Subjekti nuk arriti të provojë mundësitë financiare të bashkëshortit për krijimin e kapitalit si ortak i shoqërisë ..., në vlerën 4.000.000 lekë”.

17.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: “... mosdeklarimi në Deklaratën “Vetting” prej bashkëshortit në cilësinë e personit të lidhur ... ka ardhur prej kuptimit që unë i kam bërë tagrave të disponimit në lidhje me këtë pasuri dhe nuk kam pasur si qëllim fshehjen e tyre, pasur parasysh që kjo shoqëri është deklaruar në DV prej tij. Duke qenë se shoqëria ku janë investuar këto aksione nuk ka pasur aktivitet që prej vitit 2007, dhe nuk ka gjeneruar të ardhura, duke bërë që ky të jetë një investim i dështuar, unë nuk kam vlerësuar se duhej deklaruar duke e konsideruar një pasuri e humbur dhe që nuk ekziston më... ... investimi nga ana e bashkëshortit tim në këtë shoqëri e ka burimin nga të ardhurat familjare të tij, të realizuara nga emigracioni i babait të tij... Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga emigracioni nga vjehri im ***.***, gjendem në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion...”.

17.5 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: “... Shoqëria ku janë investuar këto aksione nuk ka pasur aktivitet që prej vitit 2007 dhe nuk ka gjeneruar të ardhura. Sipas konfirmimeve të institucioneve shtetërore kjo shoqëri ka kaluar me status “pasiv” prej vitit 2016... Veprimtaria tregtare e personit të lidhur nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit dhe as me ushtrimin e detyrës së tij. Bashkëshorti i subjektit ka vepruar si tregtar në mënyrë të pavarur nga subjekti i rivlerësimit që nga momenti i krijimit të kësaj shoqërie në vitin 2004... Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e transaksionit si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, si dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Investimi i kryer nga ana e bashkëshortit të subjektit në këtë shoqëri është deklaruar se e ka burimin nga të ardhurat familjare të tij... Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni jemi në kushtet e zbatimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Nisur edhe nga fakti se kontributi i bashkëshortit të subjektit në këtë shoqëri ka qenë në vitin 2004, shumë kohë para martese me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit në kuadrin e procesit të rivlerësimit.

17.6 **Komisioneri Publik**, në vlerësim të situatës së përshkruar më sipër, mbështetur edhe në Rekomandimin e ONM-së, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimin e arritur nga Komisioni. Nga aktet në dosje, në të kundërt sa pretendon subjekti i rivlerësimit se kjo shoqëri nuk ka gjeneruar fitime për familjen e saj, rezulton se prej kësaj shoqërie janë përfituar të ardhura në formë page deri në vitin 2010, prej personave të tjerë të lidhur me subjektin, kunati, z. ***.***, dhe bashkëjetuesja e këtij të fundit, znj. ***.***. Rezulton se të ardhurat e përfituara nga kjo shoqëri deklarohen nga subjekti i rivlerësimit si një nga burimet e ligjshme të të ardhurave të këtyre personave për të krijuar shumat e dhuruara subjektit, sikundër është trajtuar edhe më sipër në këtë ankim. Gjithashtu, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se

përgjegjësia për çregjistrimin e aktivitetit të shoqërisë është e organeve tatimore, nuk gjendet i mbështetur në legjislacionin në fuqi.

17.6.1 Për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të të ardhurave të investuara në këtë shoqëri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e vjehrrit nga emigracioni janë të ardhura nga punësimi informal dhe si të tilla, ato nuk konsiderohen si burime të ligjshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Edhe vetë Komisioni, në analizën financiare të kryer të personit tjetër të lidhur ***.**, arsyeton se: “... nuk i ka përfshirë të ardhurat nga emigracioni në mesin e burimeve të ligjshme, për sa kohë që nuk provohet as shuma e të ardhurave të realizuara dhe as ligjshmëria e tyre në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës”.

17.6.2 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk arrijnë të provojnë të kundërtën e barrës së provës, duke u ndodhur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

18. Pasuri e llojit autoveturë “Audi”

18.1 Në D. -Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Automjet tip “Audi”, blerë në vlerën 4.800 euro në datën **.2.2004, i regjistruar në datë **.8.2004. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga si administrator i shoqërisë “****” sh.a., dhe të ardhura familjare. Ky automjet është blerë nga bashkëshorti përpara fillimit të detyrës sime si prokurore. Në lidhje me këtë shihni vërtetimin nga sigurimet shoqërore, që ka të përcaktuar vetëm sigurimet e derdhura. Paga ka qenë 70.000 lekë.

18.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës, dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së në vitin 2008, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: autoveturë tip “Audi A4”, viti i prodhimit 1997, me targë **, blerë në vitin 2004. Nga të ardhurat personale (pagesë pune). Paga aktuale 50.000 lekë. *Vlera: 300.000 lekë.*

18.2.1 Të njëjtin deklaram ka bërë dhe bashkëshorti i subjektit pranë ILDKPKI-së në vitin 2009, si subjekt deklarues në pozicionin e Drejtorit të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Fier.

18.3 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, pasi ka konstatuar²²: *Duket se subjekti nuk ka deklaruar saktë të ardhurat mujore të bashkëshortit të përfituar si administrator i shoqërisë “****” sh.a. Subjekti duhet të provojë mundësitë financiare të bashkëshortit për blerjen e kësaj pasurie automjet.*

18.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... Konstatimi juaj për sa i përket kontributeve shoqërore që i referohen pagës minimale për efekt fiskal qëndron, por unë në asnjë moment nuk e kam deklaruar vlerën e 70.000 lekëve si pagë për të cilën janë derdhur kontributet shoqërore, përkundrazi kam sqaruar se një pjesë e kësaj page është marr “Cash”. Në sqarimet e mia, në pyetësorin nr. 2, kam sqaruar në atë

²² Komisioni ka konstatuar se: “Në Deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar se burim për blerjen e kësaj pasurie (automjet tip “Audi”), regjistruar në datë **.8.2004, në vlerën e 4.800 euro, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti si administrator në shoqërinë “****” sh.a., në vlerën e 70.000 lekëve. Bazuar në të dhënat e sigurimeve shoqërore, kontributet e derdhura nga shoqëria nuk i përkojnë kësaj page të deklaruar nga subjekti, por pagës minimale për efekt fiskal.

periudhë kohe bashkëshorti im ka qenë në punë të ndryshme, por ka qenë punësim informal. Ky punësim i bashkëshortit ka qenë përpara se unë të krijoja lidhje me të dhe se të ardhurat e krijuara nga ky punësim nuk kanë shërbyer për të krijuar kursime apo për të kontribuar në blerjen e ndonjë pasurie gjatë bashkësisë ligjore...”.

18.5 Komisioni, për sa më sipër, ka arsyetuar se: [...] *problematikat të cilat lidhen me pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive dhe proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit [...].*

18.6 **Komisioneri Publik**, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë “autoveturë”. Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se vërtetimi i lëshuar nga ISSH²³ për pagën e përfituar nga shoqëria “***” sh.a., nga personi i lidhur, në rolin e administratorit të shoqërisë, në të cilën konfirmohet paga mujore në shumat 10.000-14.000 lekë, nuk përputhet me pagën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 70.000 lekë. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me të ardhurat nga paga të personit të lidhur, të cilat kanë shërbyer për blerjen e pasurisë “autoveturë”. Pretendimet e subjektit lidhur me përfitimin e diferencës së pagës në *cash*, gjenden të pambështetura.

IV. B Kontrolli i figurës

19. Kontrolli i figurës, si një ndër tri kriteret e rivlerësimit kalimtar, ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme²⁴ me persona të përfshirë në krimin e organizuar²⁵ apo atyre që kanë kryer deklaram të pasaktë²⁶ të të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016.

20. Kontrolli i figurës bazohet në deklaratën që plotësohet dhe dorëzohet nga vetë subjekti dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare dhe të huaja²⁷. DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë *.10.2017, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariola *** Mërtiri”, raport i deklasifikuar plotësisht, pas kërkesës së Komisionit për përditësim dhe deklasifikim informacioni.

21. Komisioni, në cilësinë e organit që ka autoritetin kushtetues për të ushtruar kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses në gjitha materialet përkatëse, ka hetuar dhe ka vlerësuar rrethanat dhe faktet, të ndërlidhura këto edhe me të dhënat e dala nga kontrolli i pasurisë, duke administruar dy *gjetje* (respektivisht nr. *** prot., datë

²³ Referohuni vërtetimit nr. *** prot., datë *.1.2017, të ISSH-së, depozituar nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së.

²⁴ Referuar pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdo mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit...

²⁵ Referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht... me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

²⁶ Sipas nenit DH, pika 4, paragrafi dy: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

²⁷ Paragrafi i dytë i nenit DH të aneksit të Kushtetutës.

7.2022 dhe nr. * prot., datë **.10.2022), të paraqitura nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së.

22. Komisioni, në referencë të përcaktimeve të nenit B, pika 3, germa “b”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 10, e ligjit nr. 84/2016, i ka çmuar *gjetjet*²⁸ së bashku me shtojcat e tyre, në cilësinë e provës, që dëshmojnë një fakt dhe rrethanë të vlefshme për qëllim të procesit të rivlerësimit, duke u njohur me të dhënat, paraqitur në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

22.1 Mosdeklarimi i kontaktit të papërshtatshëm në formularin e DSIK-së, të shtetasit z. ***.*** alias ***.*** Nga aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit për çështje eventuale të lidhura me konfliktin e interesit, sipas informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier²⁹, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, me vendimin “Për zëvendësimin e Prokurorit”, të datës **.3.2015, të Drejtuesit të Prokurorisë Fier, është caktuar për të ndjekur procedimin penal nr. ***/2012, regjistruar për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287, i K. Penal.

22.1.1 Në datën **.4.2015, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 26/1, lidhur me nenin 17, germa “a”, të K. Pr. P., ka paraqitur para Drejtuesit të Prokurorisë Fier kërkesën për heqje dorë nga hetimi i procedimit penal nr. ***/2012³⁰, duke parashtruar, ndër të tjera, arsyet se: “... dyshohet se shtetasi ***.*** (***.***), ka kryer veprimtari kriminale jashtë territorit të Shqipërisë dhe paratë e fituara nga kjo veprimtari dyshohet të jenë investuar në biznese në Shqipëri... Nga ana ime dhe e bashkëshortit tim, është lidhur kontrata noteriale... për blerjen e një sendi në të ardhmen, të një Apartamenti me sip. ndërtimore 95 m²... Fier. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet nesh dhe shtetasit ***.***, kunat i shtetasit ***.*** (***.***), ndërsa kontrata përfundimtare e blerjes së apartamentit është lidhur me shtetasin ***.*** (***.***)³¹. Pavarësisht ekzistencës së faktit penal, për shkak të kësaj marrëdhënie kontraktuale, çmoj se çdo lloj vendimmarrje e imja, për arsyet e cituara, do të dukej si e njëanshme”. Kjo kërkesë është pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë Fier, në datën **.4.2015.

22.2 Kontakte të papërshtatshme faktike. Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti³², kanë lidhje të hershme familjare dhe biznesi, direkte ose të tërthorta me anë të familjarëve ose krushqisë (të afërm të subjektit - ***.***, ***.*** dhe ***.***³³), me shtetasit ***.***, ***.***, dhe ***.***, së paku që prej vitit 2004, vitit 2007, vitit 2010, dhe më pas. Këta të fundit (shtetasit

²⁸ Për më tepër referohuni përmbajtjes së dy *gjetjeve*, si dhe anekseve përkatëse, bashkëlidhur tyre, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁹ Për më tepër referohuni shkresës nr. *** prot., datë **.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier.

³⁰ Referuar vendimit nr. ***, datë **.10.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, dokument bashkëlidhur gjetjes së ONM-së, rezulton se shtetasi ***.*** (***.***) ka qenë i shpallur në kërkim ndërkombëtar për efekt të një dënimi penal të formës së prerë (për veprën penale të “Prostitucionit dhe pjesëmarrje në organizata kriminale me qëllim trafikimin e drogës”), në shtetin italian, së paku prej vitit 2009. Ky shtetas është arrestuar në datë **.1.2014 në Fier dhe me vendimin e formës së prerë nr. ***/2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë është lejuar ekstradimi i këtij shtetasi për në Republikën e Italisë.

³¹ Referuar përmbajtjes së kontratës së datës **.4.2012, shtetasi ***.*** ka vepruar si përfaqësues me prokurë në emër të palës shitëse.

³² Referuar dokumenteve bashkëlidhur gjetjeve të ONM-së, rezulton se bashkëshorti i subjektit për një periudhë kohe, së paku prej vitit 2018, ka qenë i punësuar me rol drejtues/pagë të konsiderueshme pranë shoqërisë “*****” sh.p.k., me aksioner themelues shtetasin ***.***.

³³ Referuar përmbajtjes së formularit të DSIK-së, anëtarët e familjes në kontakt të mundshëm, të papërshtatshëm me anëtarë të kriminit të organizuar, përfshijnë krushqinë deri në nivel të dytë (vjehtëri dhe kunati/kunata).

., ***.*** dhe ***.***), kanë krijuar shoqëri të ndryshme, të cilët së bashku (personat fizikë dhe ata juridikë), po hetohen prej SPAK prej korrikut 2020 (procedimi penal nr. ***/2020), e më tej në nëntor 2020 (procedimi penal nr. ***/2020), në kuadër të së ashtuquajturës “*afëra e inceneratorëve*”³⁴.

22.3 Përdorimi i automjeteve. Përveç identifikimit të kontakteve dhe konstatimit të ndërthurjeve të vazhdueshme të interesave privatë e familjarë të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur, me këta persona të proceduar penalisht, nga aktet e administruara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, kanë pasur në përdorim automjetet në pronësi të shtetasve ***.***, ***.***, apo shoqërive të krijuara prej tyre, gjatë viteve 2019 – 2020, përkatësisht automjetin me targë: *** dhe automjetin me targë: ***.

22.4 Për sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me dy çështje: (i) Mosdeklarimin e një kontakti të papërshtatshëm të vitit 2012, dhe (ii) Marrëdhëniet e vazhdueshme shoqërore, familjare e të biznesit, të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur dhe krushqisë të tyre, me persona dhe shoqëri të hetuara nga SPAK, përfshirë personat e shpallur në kërkim nga autoritetet.

22.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka dhënë shpjegime se³⁵:

(i) Në lidhje me mosdeklarimin e kontaktit të papërshtatshëm të vitit 2012, subjekti ka parashtruar se: “... edhe nëse ky do të konsiderohej kontakt në kuptim të ligjit, nga ana ime deklarimi i tij nuk do të sillte asnjë problem, duke qenë se edhe nëse do të kishte ekzistuar, ai do të përbënte një kontakt rastësor të personit tim të lidhur, për shkak të kësaj marrëdhënie kontraktuale dhe jo njohje e familjes time”;

(ii) Në lidhje me kontaktet e papërshtatshme faktike, subjekti ka parashtruar se: “... Lidhja e vetme e imja dhe bashkëshortit tim ndërmjet personave të cituar ***.***, ***.***, dhe ***.***, është ajo me shtetasen ***.***. Sikurse kam sqaruar në përgjigje të pyetësorit standard, shtetasja ***.*** është bashkëjetuesja e kunatit tim... dhe bashkëjetojnë prej vitit 2004.... kjo lidhje është ndërprerë plotësisht prej momentit kur unë kam rënë në dijeni se ndaj saj ishin zhvilluar hetime dhe ishte nxjerrë një masë sigurimi... Ngjarjet e ndodhura në dhjetor të 2021 apo aktualisht nuk mund të afektojnë kriterin e figurës sime...”;

(iii) Në lidhje me punësimin e bashkëshortit (pranë shoqërisë “****” sh.p.k., prej vitit 2018), subjekti ka parashtruar se: “... Bashkëshorti im, shtetasi ***.***, ka qenë i punësuar pranë shoqërisë... në pozicionin e drejtorit të sigurisë. Ky pozicion pune nuk ka funksione drejtuese, pasi nuk gëzon asnjë kompetencë vendimmarrëse...Punësimi i bashkëshortit tim te kjo shoqëri nuk është kryer nga shtetasi ***.***”;

(iv) Në lidhje me përdorimin e automjeteve, subjekti ka parashtruar se: “... Në drejtim të Malit të Zi (për shkak të një aktivitet zyrtar), kemi udhëtuar me mjetin me targë ***... Sqaroj se unë

³⁴ Për më tepër referohuni informacionit të përcjellë nga SPAK drejtuar Komisionit dhe ONM-së, me shkresat nr. *** prot., datë **.6.2022; nr. *** prot., datë **.6.2022 dhe shkresa me nr. *** prot., datë **.11.2022, si dhe gjetjeve të ONM-së, së bashku me shtojcat përkatëse bashkëlidhur.

³⁵ Për më tepër referohuni shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

*nuk e kam përdorur personalisht në asnjë rast mjetin e sipërcituar, por vetëm kam udhëtuar si pasagjere në datën **.1.2019... Automjeti me targë: *** ka qenë në përdorim nga kompania “***” sh.p.k., ku bashkëshorti ka qenë i punësuar... Sikurse rezultoi nga të dhënat e administruara nga ana juaj, mjetet me targa... janë përdorur në vitet 2019 dhe 2020 vetëm një herë, shumë kohë përpara kohës së procedimeve të këtyre personave”.*

22.6 Komisioni, pasi i ka gjetur të drejta të gjitha shpjegimet e subjektit, duke i bërë pjesë edhe të arsytimit të tij³⁶, ndër të tjera, për vlerësimin në tërësi për kriterin e figurës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Subjekti i rivlerësimit për shkak të marrëdhënieve familjare, ka lidhje me shtetasin ***.*** (kunati i subjektit), dhe bashkëjetuesen e tij ***.*** Në asnjë rast apo rrethanë nuk u konstatua që subjekti apo bashkëshorti i saj kanë pasur kontakte me këta persona pas regjistrimit të procedimit penal ndaj tyre. Gjithashtu në asnjë rast të vetëm nuk u konstatuan kontakte të papërshtatshme të subjektit apo bashkëshortit të saj me personat ***.*** (***.*** - shën. im), ***.*** dhe ***.*** [...³⁷].*

23. Komisioneri Publik, mbështetur në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së dhe përmbajtjes së *gjetjeve* të vëzhguesit ndërkombëtar, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Duket se Komisioni, në vlerësimin e kriterit të figurës, mbështetet në një interpretim të ngushtë dhe formal të dispozitave ligjore të zbatueshme, duke iu referuar nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 - për rastin e kontaktit të papërshtatshëm të vitit 2012, dhe momentit të fillimit të procedimit penal nga ana e SPAK - për personat (dhe shoqëritë tregtare të krijuara prej tyre), që janë konstatuar si kontakte të papërshtatshme faktike të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

23.1 Komisioneri Publik, në analizë të të gjithë fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, vlerëson se interpretimit që Komisioni i ka bërë normës kushtetuese, nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk vjen në harmoni me vetë qëllimin e procesit të rivlerësimit, të shprehur në nenin 179/b, të Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, i cili është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë që ka ky proces në rikthimin e besimit të publikut, i cili gjen vend në vetë qëllimin dhe frymën e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, procesi i rivlerësimit synon që të identifikojë ata subjekte rivlerësimi, të cilët, nga faktet dhe rrethanat e dala, rezultojnë se janë të papërshtatshëm për vijimin e detyrës. Në këtë vështrim, Komisioni në asnjë moment nuk ka arsyetuar dhe vlerësuar nëse rrethanat e dala, paraqitur si *gjetje* nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbëjnë bazë të mjaftueshme brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

23.2 Duke iu rikthyer analizës së fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i rastit objekt ankimi, në vëmendje të përmbajtjes së aktit Rekomandim dhe *gjetjeve* të ONM-së, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mosdeklarimin e kontaktit të papërshtatshëm të saj/personit të lidhur me të,

³⁶ Për më tepër referohuni “Vlerësimi të Komisionit” për pikën 1.5, f. 39; f. 41 dhe f. 43, të vendimit.

³⁷ Për më tepër referohuni në pikën 1.6, f. 43, të vendimit të Komisionit.

bashkëshortit, me shtetasin ***.*** (***.***), në prill të vitit 2012, sikurse e kërkon ligji nr. 84/2016, sipas shtojcës nr. 3 – “*Deklarata për Kontrollin e Figurës*”. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk gjenden të bazuara në provat e administruara, pasi:

Referuar përmbajtjes së kërkesës të subjektit të rivlerësimit të datës **.4.2015, për dorëheqje nga hetimi i procedimit penal nr. ***/2012, rezulton se subjekti ka pasur dijeni të plotë, si për faktin e problemeve ligjore me drejtësinë të shtetasit ***.*** (shtetas i cili për qëllim të procesit të rivlerësimit, përfshihet në përcaktimin e pikës 15³⁸, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016), ashtu dhe për faktin e kontaktit me këtë person, në muajin prill të vitit 2012, kohë në të cilën, personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti, hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me të. Rrethanat dhe arsyet e këtij kontakti, rezultojnë në kujtesën e subjektit të rivlerësimit, i cili në kërkesën për dorëheqje nga procedimi penal me këtë shtetas, parashtron se: “... *Nga ana ime dhe e bashkëshortit tim, është lidhur kontrata noteriale... për blerjen e një sendi në të ardhmen ... Kjo kontratë është lidhur ndërmjet nesh dhe shtetasit ***.***, kunat i shtetasit ***.*** (***.***), ndërsa kontrata përfundimtare e blerjes së apartamentit është lidhur me shtetasin ***.*** (***.***). Pavarësisht ekzistencës së faktit penal, për shkak të kësaj marrëdhënie kontraktuale, çmoj se çdo lloj vendimmarrje e imja, për arsyet e cituara, do të dukej si e njëanshme*”.

Duket se subjekti i rivlerësimit, në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë për dorëheqje nga çështja penale, nuk e shihte pozicionin e saj të shikëputur, sikundër ka pretenduar për të njëjta rrethana gjatë hetimit administrativ, lidhur me kontaktin e papërshtatshëm. Për më tepër, duket se pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur në asnjë rast kontakt me shtetasin ***.*** (***.***), nuk gjendet i bazuar referuar përmbajtjes së kontratës së prillit 2012³⁹.

23.3 Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka plotësuar me mangësi shtojcën nr. 3, “*Deklarata për kontrollin e figurës*”, pasi nuk ka deklaruar kontaktin me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe shkëmbimin/shitblerjen e pasurisë ndërmjet tyre (Shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016, pjesa 5, gerrat “d⁴⁰” dhe “e⁴¹”). Në referencë të legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri Publik çmon se vlerësimi i Komisionit në këtë rast ka qenë i mangët, në raport me faktet e rrethanat e çështjes dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nën dritën e përcaktimeve të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁴², i cili ka mbajtur qëndrimin se: [...] *kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklarimit [...], vlerësohet se subjekti i*

³⁸ “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht brenda ose jashtë territorit të RSH-së, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009....

³⁹ Sipas kësaj kontrate noteriale, rezulton përmbajtja: “*Sot në Fier, më dt. ** Prill 2012... , para meje Noterit ***.***, në zyrën noteriale të ndodhur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, u paraqiten personalisht shtetasit me cilësinë e palëve të poshtëshënuara...*”.

⁴⁰ Referuar shtojcës nr. 3, pjesa 5, “Të dhëna për sigurinë”, në germen “d”, shtrohet pyetja: “*A jeni në dijeni që një nga anëtarët e familjes (me termin “anëtar familjeje”, do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë...) suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar*”?

⁴¹ Referuar shtojcës nr. 3, pjesa 5, “Të dhëna për sigurinë”, në germen “e”, shtrohet pyetja: “*A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar*”?

⁴² Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 30/2019.

rivlerësimit/personi i lidhur me të, kanë pasur një kontakt të papërshtatshëm, për të cilin, subjekti i rivlerësimit, ka pasur detyrimin ligjor ta deklaronte sipas shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi i këtij kontakti ka shkaktuar pasaktësi në plotësimin e këtij formulari, në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Ky fakt përbën një të metë, i cili në këndvështrim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84 /2016 dhe të nenit DH, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

23.4 Komisioneri Publik ndan vlerësim të ndryshëm me Komisionin edhe për faktet dhe rrethanat e konstatuara për ***kontaktet e papërshtatshme faktike*** (shtetasit ***.***, ***.***, ***.***, dhe ***.***), ***punësimi i personave të lidhur të subjektit në kompani të krijuara nga këta shtetas, përdorimi i automjeteve, udhëtimet*** etj.. Duke u bazuar në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, përmbajtjes së *gjetjeve* të vëzhguesit ndërkombëtar dhe jurisprudencës së Kolegjit, çmojmë se përfundimi i Komisionit është rrjedhojë e një vlerësimit të mangët, i pabazuar në prova dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm.

23.5 Komisioni në vlerësimin e rastit, duket se është bazuar edhe në momentin procedural të regjistrimit të hetimit penal nga ana e SPAK-ut, si dhe regjistrimit të emrave të personave fizikë dhe ata juridikë, në kuadër të këtyre hetimeve, duke arritur, ndër të tjera, në përfundimin: *se në asnjë rast apo rrethanë nuk u konstatua që subjekti apo bashkëshorti i saj kanë pasur kontakte me këto persona pas regjistrimit të procedimit penal ndaj tyre.*

23.6 Referuar jurisprudencës së Kolegjit (vendimit (JR) nr. 5/2019, 30/2019 etj.), deri më tani, kjo gjykatë ka mbajtur qëndrimin, se lidhur me mjaftueshmërinë dhe vërtetësinë e deklarimit, për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës ** janar 2012, pra edhe përpara afatit me pikënisje datën ** janar 2012, përcaktuar sipas pikës 2, të nenit Dh, të aneksit të Kushtetutës. Nisur nga kjo praktikë, për qëllim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit 179/b, të aneksit të Kushtetutës, do të përbënte një vlerësim logjik, objektiv dhe proporcional, nëse kontrolli për kontakte të papërshtatshme, kur ato provohen me prova të besueshme dhe të mjaftueshme, do të shtrihet edhe pas datës së deklarimit/plotësimit të shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vështrim, duket se ka qenë edhe vlerësimi i Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2020, ku, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se: [63.] ... *Vetë përcaktimi i këtij afati me pikënisje datën ** janar 2012 dhe pikë fundore datën e deklarimit sipas ligjit, konfirmon më së miri se, në lidhje me këtë periudhë kohore, do të vlerësohet saktësia dhe vërtetësia e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016 **dhe jo ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme** [...].*

23.7 Komisioni, si organi që ka autoritetin kushtetues për kontrollin dhe vlerësimin e kriterit të figurës, ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme faktike, të subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, e ka administruar në formën e *gjetjeve* (së bashku me shtojcat e tyre), paraqitur nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar, në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të, administruar në bazë të nenit 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016. Në shqyrtim të këtyre akteve, rezulton se, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, kanë pasur marrëdhënie jo vetëm sociale e familjare, por edhe biznesi dhe punësimi me z. ***.***,

., ***.*** dhe ***.***, të gjithë këta të hetuar nga SPAK për akuza të krimit të organizuar, në kuadër të të ashtuquajturës “*afera e inceneratorëve*”⁴³. Referuar gjetjeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultojnë rrethanat si më poshtë⁴⁴:

(i) Në janar të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar së bashku me shtetasen ***.*** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka udhëtuar në drejtim të Vjenës në vitin 2018, për të vizituar kunatin për qëllime shëndetësore;

(ii) Në vitin 2018, shoqëritë “***.***” sh.p.k., dhe “***” sh.p.k., në pronësi të shtetasve ***.***, dhe ***.***, si dhe shoqëria “*** Fier” sh.p.k., administruar nga ***.***, referohen në mediat publike, si të përfshira në korrupsion në çështjen e inceneratorëve;

(iii) Në janar të vitit 2019, subjekti i rivlerësimit ka përdorur automjetin në pronësi të ***.***. Ky automjet rezultoi i përdorur edhe nga shtetasit ***.***, ***.***, ***.***, ***.***, etj., të gjithë të hetuar nga SPAK, në kuadër të të njëjtit hetim penal;

(iv) Në qershor 2020, mediat publike raportojnë dorëzimin e një kallëzimi penal pranë SPAK, nga ana e “***”, lidhur me çështjet e inceneratorëve, kompanitë dhe personat e përfshirë;

(v) Në nëntor të vitit 2020, SPAK regjistron procedimin penal mbi bazën e kallëzimit të mësipërm, ndërsa në dhjetor 2020 rezultoi se personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti ka përdorur automjetin që i përkiste shoqërisë “***” sh.p.k.;

(vi) Në maj të vitit 2021, shtetasja ***.*** ishte zyrtarisht nën hetim nga SPAK. Ndërsa shtetasit ***.***, në dhjetor 2021; shtetasi ***.***, në mars 2022; shtetasit ***.*** (kunati i subjektit) dhe shtetasi ***.***, në nëntor 2022, për të njëjtën çështje;

(vii) Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, shtetasi ***.***, ka punuar për shoqërinë “***” sh.p.k., deri në ** gusht të vitit 2022. Sipas vërtetimit të ISSH-së nr. *** prot., datë **.6.2020, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie me një pagë shumë të lartë.

23.8 Nisur nga sa më sipër, mbështetur edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi, në vlerësim të Komisionerit Publik, ekzistojnë një seri e qartë faktesh dhe rrethanash, të provuara nga aktet e administruara, që tregojnë për një vazhdimësi lidhjeje midis subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj (kunatit, kunatës dhe vjehrrit), me partnerët/punëdhënësit e tyre të biznesit, gjatë viteve 2002-2022, specifikisht me ***.*** dhe ***.***. Rezultoi gjithashtu se ***.*** dhe ***.***, janë hetuar nga SPAK në lidhje me aktivitetet e tyre private, krijuara prej vitit 2011, 2014 e në vazhdim, sikurse edhe për implementimin e kontratave koncesionare në lidhje me inceneratorët.

23.9 Nga aktet e administruara, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur marrëdhënie biznesi me të vëllain (***.***), së paku deri në vitin 2010, kur nga shoqëria “***” sh.p.k., nga ana e kunatit, ***.***, dhe bashkëjetueses së tij, ***.***, gjeneroheshin të ardhura

⁴³ Për më tepër referohuni në gjetjet nr. *** prot., datë **.7.2022 dhe nr. *** prot., datë **.10.2022 dhe anekset përkatëse, si dhe Rekomandimit për paraqitje ankimi datë **.2.2023.

⁴⁴ Për më tepër referohuni edhe në f. 12-16, të Rekomandimit të ONM-së.

në formë page të deklaruara si një nga burimet e shumës së dhuruar subjektit në vitin 2011. Edhe në gusht të vitit 2017, rezulton se ***.*** shfaqet si administrator i kompanisë, ndërkohë që ***.***, bashkëshorti i subjektit ishte aksioneri kryesor. Shtetasit ***.*** dhe ***.***, kanë lidhje biznesi/punësimi me personat e tjerë të lidhur të subjektit (kunatin ***.***, ***.***, dhe vjehri ***.***), prej vitit 2007-2013, si dhe 2014-2016, periudhë gjatë së cilës rezulton se janë krijuar kompanitë e lidhura me inceneratorët, të shfrytëzuara dhe administruara nga këta persona, si dhe me bashkëshortin, lidhur me punësimin e tij në kompaninë bijë (***.***. *** ***), prej vitit 2018, duke mbajtur në konsideratë këtu dhe pozicionin dhe përfshirjen e ***.***, në kompaninë mëmë. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Komisioneri Publik vlerëson se ngjarjet e vitit 2018, kur çështja u bë publike, si dhe në qershor të vitit 2020, kur çështja iu referua për hetim SPAK, janë relevante për t'u vlerësuar në ndikimin që kanë në besimin e publikut, për qëllim të procesi të rivlerësimit. Sa i përket punësimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe përdorimit të automjeteve, vlerësojmë se pretendimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nuk provojnë të kundërtën e barrës së provës.

24. Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se për kontrollin e kriterit të figurës, gjenden fakte të cilat e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Ky vlerësim negativ qëndron edhe nga një vlerësim tërësor i çështjes, pasi gjenden një sërë rrethanash, të vlefshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. C Për vlerësimin e aftësive profesionale

25. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit, bazohet në aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësia organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

26. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka administruar dhe *gjetjet* e vëzhguesit ndërkombëtar, të cilat ngrenë çështje për vlerësim e etikës, konfliktit të interesit dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi administrativ kanë rezultuar disa mangësi, të tilla që për nga provueshmëria e tyre sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kanë kaluar si barrë prove subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të kundërtën. Në vijim, do gjejmë trajtim si shkaqe ankimi, dy çështjet që lidhen me shoqërinë “****” sh.a., dhe katër çështje me Bashkinë Fier, të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

27. Procedim penal nr. */2015**

27.1 Komisioni ka administruar, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier⁴⁵, dosjen që i përket procedimit penal nr. ***/2015, regjistruar për veprën penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera*”, parashikuar nga neni 258 i K. Penal. Në vlerësim të akteve të përcjella lidhur me këtë procedim penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, të datës **.10.2015, ka regjistruar kallëzimin penal të

⁴⁵ Për më tepër referohuni shkresës me nr. *** prot., datë **.5.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier.

datës **.6.2015, paraqitur nga shtetasit ***.*** dhe ***.***, përfaqësues të shoqërisë “*** ” sh.p.k., dhe personit fizik “***.***”.

27.2 Fakti i pretenduar penal nga kallëzuesit lidhet me pengimin dhe veprimeve të dyshuara korruptive për të marrë pjesë në ankandin e zhvilluar nga shoqëria “***” sh.a., me objekt shitje skrap. Pas regjistrimit të procedimit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar dhe ndjekur disa veprime hetimore, si: pyetjen e kallëzuesve, disa nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të shoqërisë “***” sh.a., personat përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e shoqërisë, kërkim për informacion pranë shoqërisë dhe Komisionit të Prokurimit Publik etj., zhvilluar gjatë muajve qershor të vitit 2015 deri në shkurt 2016. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës ** mars të vitit 2016, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2015, me arsyetimin se fakti i pretenduar nuk parashikohet si vepër penale. Komisioni, pasi ka konstatuar se hetimi përmban të meta, i ka kaluar subjektit barrën e provës për sa vijon:

(i) Hetimi përmban të meta të dukshme procedurale dhe materiale, të tilla si: regjistrimi shumë i vonuar i çështjes, mosnxjerrje e vendimeve mbi shtyrjen e veprimeve hetimore çdo tre muaj, mosbërje në kohën e duhur të hetimeve për mbledhjen e informacionit dhe dëshmive sa më të vërteta, të pamanipuluara nga koha apo faktorë të tjerë, mosballafaqimi i deklaratave, mosmbledhja e tabulateve telefonike⁴⁶, mungesa e përgjimeve për të kuptuar dinamikën e mundshme të personave të përfshirë, mosmarrja e dëshmive të pjesëmarrësve të tjerë që mbetën jashtë ankandit⁴⁷;

(ii) Konstatohet një situatë e mundshme konflikti interesi gjatë hetimit të çështjes;

(iii) Në hetimin e çështjes mund të përfshiheshin jo vetëm anëtarët e vlerësimit të ofertave, por më e rëndësishmja, administratori i shoqërisë (punëdhënësi dhe eprori i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), si përfaqësues i autoritetit kontraktor, që përcakton rregullat e ankandit dhe si personi që përfundimisht vendos pezullimin ose miratimin e procedurave të ankandit dhe palët fituese; si dhe punëdhënësin/eprorin e rojeve...

27.3 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në shpjegimet⁴⁸ e saj ka deklaruar se: “... *Materiali më ka kaluar për ndjekje në datë **.6.2015, verifikimet kanë filluar prej meje në datë **.7.2015, dhe... veprimet e mia janë kryer brenda një jave.... Ligji i kohës kur është regjistruar ky procedim penal, në nenin 290 të K. Pr. Penale, nuk përcaktonte afat në fazën e kryerjes së verifikimeve të materialit kallëzues. Në lidhje me mosnxjerrjen e vendimeve mbi shtyrjen e veprimeve hetimore çdo tre muaj sqaroj se procedimi penal i sipërcituar është regjistruar në regjistrin e veprave penale pa autor, kështu që nuk mund të procedoja sipas nenit 324 të K. Pr. Penale, që parashikon zgjatjen e afateve të hetimit⁴⁹. Për sa i përket mosmbledhjes së tabulateve telefonike ..., ka shpjeguar se fillimisht vepra penale është regjistruar sipas nenit 258 të K. Penal, i cili parashikon një dënim gjer në 3 vjet burgim. Ndërkohë, që neni 221 i K.*

⁴⁶ Këto do të mund të hidhnin dritë mbi komunikimet mes anëtarëve të komisionit apo zyrtarëve të tjerë të lartë të kompanisë me rojet.

⁴⁷ Nga 10 pjesëmarrës vetëm një mundi të hynte në ambientet e shoqërisë në kohën e duhur, dhe ky rezultoi fitues.

⁴⁸ Për më tepër referohuni shpjegimeve të dhëna nga subjekti në rezultatet e hetimit.

⁴⁹ Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj... ii. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se 3 muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë 2 vjet.

Pr. Penale parashikon kufijtë e lejimit të përgjimit për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak se shtatë vjet...”.

27.4 Komisioni i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se veprimet dhe ndjekja e hetimeve është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk e ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit.

27.5 **Komisioneri Publik**, mbështetur në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së dhe përmbajtjes së *gjetjeve* të vëzhguesit ndërkombëtar, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe rrethanave të dala nga vlerësimi i këtij rasti. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Pretendimi i subjektit se hetimi është kryer brenda një jave, nuk përputhet me gjendjen faktike të akteve në dosje, pasi gjatë muajit korrik, subjekti ka kryer disa veprime procedurale duke marrë informacion rreth zhvillimit të ankandit. Hetimi i ndjekur nga subjekti duket se nuk ka qenë thelbësor deri në ** tetor 2015, moment në të cilin vendos të regjistrojë çështjen penale. Ndërkohë, pretendimi i subjektit për ngarkesën në punë ngelet në nivel deklarativ.

27.5.1 I pambështetur gjendet edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka afat ligjor në fazën e kryerjes së verifikimeve të materialit kallëzues, pasi referuar urdhrin nr. 2/2006 të Prokurorit të Përgjithshëm (i cili ka ndryshuar urdhrin nr. 241/2005), “*Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale*”, në pikën 2.2, parashikon si afat maksimal 20 ditë për të bërë verifikime për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale. Ndërsa në pikën 2.1, parashikohet se në raste të veçanta, kur me gjendjen e akteve, prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe mund të bëhet një minimum verifikimesh, nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. Pra, në çdo rast, ekziston një afat lidhur me kryerjen e verifikimeve për materialin kallëzues. Edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit për mungesën e vendimeve të zgjatjes së afateve të hetimit për shkak se është regjistruar në regjistrin e veprave penale pa autor, nuk duket bindës, pasi neni 287 i K. Pr. P., të cilit i referohet subjekti, kërkon regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe jo regjistrimin e personit nën hetim. Në rastin në fjalë, është e qartë që kjo veprë penale, ndër të tjera, i atribuohet rojeve në shërbim të shoqërisë “***” sh.a., ditën e tenderit.

27.5.2 Referuar akteve të procedimit penal, një prej përfaqësuesve të shoqërive pjesëmarrëse në tender, pretendon për shoqërinë “***” sh.a., edhe në lidhje me vepra të tjera penale, që parashikojnë marzh më të lartë dënimi, pasi pretendohet për veprime korruptive lidhur me dokumentacionin e tenderit, specifikimet teknike që ngrenë dyshime për klientelizëm dhe një procedurë diskriminuese që paracakton fituesin e tenderit. Kjo ankesë së bashku me rrethanat dhe faktet e tjera në dosje, duhet të bënte që hetimi të ishte drejtuar në akuzat për korrupsion, të dënueshme deri në 8 vjet, duke u përfshirë kështu brenda kufijve të parashikuar nga neni 221 i K. P. Penale⁵⁰. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit do mund të mblidhte tabulatet

⁵⁰ Për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet.

telefonike, të cilat do të hidhnin dritë mbi komunikimet mes anëtarëve të komisionit apo zyrtarëve të tjerë të lartë të kompanisë me rojet.

